

Udhëzues për raportimin e ekstremizmit të dhunshëm



1. Të përdoren fakte dhe të shmangen paragjykimet

Gazetarët duhet të sigurohen që të raportojnë në mënyrë objektive, të saktë, të paanshme, gjithëpërfshirëse, të pavarur dhe duke marrë për bazë faktet. Gazetarët duhet të raportojnë në mënyrë profesionale dhe në pajtim me kodin e etikës për gazetarë, si dhe t'i sfidojnë gjithë ndikimet që burojnë nga narrativat politike. Gjithashtu duhen shmangur ekzagjerimet, propaganda, lajmet e rrejshme dhe raportimi i storieve pa verifikim paraprak të burimeve të informacionit, ndërsa tema duhet trajtuar me paanësi nëpërmjet një procesi transparent të raportimit.

#UnitedCVE



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

2. Të njihet terminologjia e saktë e lidhur me ekstremizmin e dhunshëm

Është thelbësore që gazetarët ta njohin terminologjinë dhe ta përdorin në mënyrë korrekte në raportimet e tyre. Mësojini konceptet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm para se të raportoni rreth tyre. Sigurojuni që audienca juaj t'i kuptojë konceptet e lidhura me ekstremizmit e dhunshëm. Vetëdijesimi rreth perceptimeve të audiencës dhe kontekstualizimi i mirëfilltë i këtyre koncepteve janë të dyja njëjloj të rëndësishme për të siguruar raportim profesional dhe të paanshëm.

3. Raportimi të jetë i bazuar në vlerat etike dhe humanitare

Vlerat humanitare janë gurthemel i gazetarisë etike. Gjithashtu, është me rëndësi që gazetarët të mos e formësojnë storien në atë mënyrë që të bëhet e stërthjeshtuar vetëm dhe vetëm që të mund ta fusin në kornizat e një rrëfimi humanitar, pa e përfshirë fare kontekstin e duhur. Veç kësaj, gazetarët duhet ta shmangin viktimizimin, ngaqë një gjë e tillë mund të shkaktojë po ashtu që protagonistët e stories ta humbasin mbështetjen që kanë. E njëjta vlen dhe për viktimizimin e të dyshuarve apo kryerësve të veprës së ekstremizmit të dhunshëm.

4. Të dëgjohen të gjithë zërat

Gazetari duhet të sigurojë që të dëgjohen të gjithë zërat, sidomos zëri i grupeve të marginalizuara apo komuniteteve joshumicë. Gazetari duhet të sigurohet që t'i verifikojë informatat që i merr nga zëdhënësit e vetëmëruar të këtyre komuniteteve, për t'i shmangur shtrembërimet dhe përgjithësimet, përfshirë këtu dhe zëdhënësit nga bashkësia islame apo bashkësitë e tjera fetare. Gazetarët duhet të garantojnë një përfaqësim të baraspeshuar që pasqyron mendimet e një grupi apo komuniteti në shkallën më të lartë të mundshme, duke pasur numër sa më të madh dhe të larmishëm të burimeve të informatave.

5. Të shmanget përmbajtja nxitëse gjatë raportimit për ekstremizmin e dhunshëm.

Gazetarët duhet të sigurojnë që të mos publikojnë përmbajtje nxitëse, ngaqë një gjë e tillë mund të prodhojë pasoja të rënda dhe efekte negative që mund të çojnë në keqinterpretim të dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm, keqkuptime dhe mundësi më të madhe për urrejtje dhe konflikt. Terminologjia e lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin duhet të përdoret me kujdes, ndërsa përdorimi vend e pa vend i fjalëve "ekstremist", "terrorist" dhe "xhihadist" duhet të shmanget.